



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. Org. / Org. Jedin. / Org. Unit:	01 / 02
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No:	579 / 2022
Nr. i faqave / Broj stranica / No. pages:	29 / 03 / 2022
PRISTINE	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Nr. 22 / 2022
Datë: 29.03.2022

Në mbështetje të nenit 21, paragrafit 2, 3 dhe 4, nenit 23, paragrafit 3, nenit 31, paragrafi 2, nenit 32, paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, dhe nenit 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e plotësuar dhe nryshuar me Rregulloren Nr. 04/2021, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Afati sa i përket Tatimit në Pronë shtyhen si në vijim:
 - 1.1 Afati për lëshimin e faturave të tatimit në pronë zgjatet deri më **31 Mars 2022**.
 - 1.2 Afati për paraqitjen e ankesave ndaj faturës së tatimit në pronë dhe certifikatave të vlerave të vlerësuara zgjatet deri më **31 Maj 2022**.
 - 1.3 Afati për pagimin e kështit të parë të detyrimeve të tatimit në pronë zgjatet deri më **30 Qershor 2022**.
2. Afati për deklarimin e tatimit në të ardhurat personale për periudhën tatimore 2021 zgjatet deri më **31 Maj 2022** dhe bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-102 dhe Nr. 04/L-223, si dhe Ligjin Nr. 05/L-028 për Tatimit në të Ardhurat Personale.
3. Deklarimet dhe pagesat e bëra deri në afatin e zgjatur sipas këtij vendimi nuk i nënshtrohen ndëshkimeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Për llojet tjera të tatimeve dhe kontributeve, përveç atyre të përmendura shprehimisht me këtë vendim, afati për deklarim dhe pagesë mbetet ashtu siç është i përcaktuar me legjislacionin në fuqi.

5. Obligohen Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Zyrat e Tatimit në Pronë në Komuna dhe Administrata Tatimore e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Në mbështetje të tatimpaguesve dhe efekteve negative ekonomike të shkaktuara nga pandemia, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve ka vendosur të zgjasë afatin për deklarimin e tatimit në të ardhurat personale për periudhën tatimore 2021, si dhe të zgjasë afatin e lëshimit të faturave të tatimit në pronë, për shkak se të njëjtat nuk janë shpërndarë brenda afateve ligjore nga Posta e Kosovës dhe nga zyrtarët komunal të komunave që nuk kanë pasur marrëveshje me Postën.

Me rastin e mos-shpërndarjes me kohë të të gjitha faturave, tatimpaguesit mund të humbin afatin ligjor për parashtrimin e ankesave për vitin tatimor 2022, afat i cili mbaron më 31 Mars 2022.

Rrjedhimisht, duke pasur në konsideratë konstatimet e mësipërme, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Hekuran Murati
Ministër i Financave, Punës dhe Transfereve

Iu dërgohet:

- Të gjitha Komunave;
- Departamentit të Tatimit në Pronë;
- Administratës Tatimore të Kosovës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MFPT-së; dhe
- Arkivit të MFPT-së.